

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: *Mbikqyrje e punimeve për objektin: Rikonstrukcion Rruga "Ernest Bushati"*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT **FPP**): 79714000-2 - Shërbime të mbikqyrjes

VLERA E FONDIT LIMIT: **205,646** (dyqind e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Shkoder ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

*Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit e konkretisht **82,258** (tetëdhjetë e dymijë e dyqind e pesëdhjetë e tetëmijë) lekë.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" "Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ka ushtruar aktivitet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet e kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin Mbi Të Ardhurat", të Ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe konkretisht **41,129 (dyzet e njëmijë e njëqind e njëzet e nëntë)** lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4. "ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën" dhe nenit 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". *Per kontrata e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jete ne një vlerë jo me te madhe se 20 % te vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates".*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jete afer limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për "**Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi**", e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) ose Kontrata bashkëpunimi të vlefshme me shoqëri ose inxhinierë të liçensuar për këto kategoritë:

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

### **Punime të përgjithshme ndërtimi:**

Kategoria NP-1 Niveli A "Punime germimi"

Kategoria NP-3 Niveli A "Rikonstrukcion dhe M/M godina civile dhe industriale.."

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime..”  
Kategoria NP-7/a Niveli A “Ujesjellesa, kanalizme, vepra kullimi dhe vaditje ,...”  
Kategoria NP-11 Niveli A “Ndertime N/Stacionet kabinat e transformatoreve .....”

**Punime speciale ndërtimi:**

Kategoria NS-1 Niveli A Punime per prishjen e ndertimeve  
Kategoria NS-6 Niveli A “Punime për sinjalistiken”  
Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”..

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**Argumentimi:** Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve që do realizohen sipas preventivit dhe projektit. Konkretisht

**Punime të përgjithshme ndërtimi:**

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”  
Kategoria NP-3 Niveli A “Rikonstrukcion dhe M/M godina civile dhe industriale..”  
Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime..”  
Kategoria NP-7/a Niveli A “Ujesjellesa, kanalizme, vepra kullimi dhe vaditje ,...”  
Kategoria NP-11 Niveli A “Ndertime N/Stacionet kabinat e transformatoreve .....”

**Punime speciale ndërtimi:**

Kategoria NS-1 Niveli A Punime per prishjen e ndertimeve  
Kategoria NS-6 Niveli A “Punime për sinjalistiken”  
Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”..

Për të gjitha këto zera të punimeve operatori ekonomik që do të realizojë shërbimin e mbikqyrjes duhet të zotërojë liçensën profesionale me pikat e sipërpermendura.

Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier topograf
- 1 (një) inxhinier elektrik

Inxhinieret e mësipërm duhet të jetë i licensuar per kategorite e kerkuara, të vërtetuar me Licence profesionale te shoqerise ose Licence individuale, kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per te pakten muajin e fundit.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.3 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese me Bashkine Shkoder.**

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri per stafin eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit te zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur per zbatimin e kesaj kontrate

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

**2.3.4** Një punësim mesatar i te punesuarve prej të paktën **5 (pesë)** personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për kete muaj.
- b) Listpagesa e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi per periudhen e mesiperme.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

Është kërkuar vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Eshte kerkuar nr. punonjesish prej 5(pese) personash duke llogaritur ne te stafin drejtues dhe ate mbeshtetes per realizimin e kontrates

### **1.1 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim.

**Argumentimi:** Është vendosur kjo kërkesë bazuar në njoftimin me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.